

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" ZDRAVA 2025" SHPK

Sot me daten 17/01/2025 (dymijë e njëzet e pesë), ne ortakët themelues :

- **1 Z.KRESHNIK ZDRAVA** shtetas shqipëtar, i datëlindjes 19 Dhjetor 1985, lindur në Berat dhe banues në Durrës , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr I51219045A.
- **2 Z.GENCI ZDRAVA** shtetas shqipëtar, i datëlindjes 26 Tetor 1981, lindur në Berat dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I11026124J.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "ZDRAVA 2025" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " ZDRAVA 2025" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Përmet,Rruga Kutal ,me numër pasurie 13/5 ,zona kadastrale 2348.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Projektme civile dhe industriale, punime të ndryshme ndërtimi si armim dhe disarmim armature, dërrase dhe metalike, përpunime hekur ndërtimi, mirëmbajtje godinash dhe montim të kapanoneve industriale. Kryerja e aktiviteteve tregtare në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme civile, private dhe publike dhe rikonstruksioni i tyre. Projektim dhe ndërtim i rrjeteve hidraulike, elektrike, të ajrimit dhe kondicionimit, restaurim dhe mirëmbajtje vepra arti dhe monumente kulture. Ndërtim ujësjellësash, kanale vadtës dhe kullues, impiante vadtëse dhe vepra të tjera mbrojtëse. Ndërtim rrugësh dhe urash të të gjitha kategorive,diga, tunele, galeri, si dhe mirëmbajtjen e tyre

Genç

R

përfshirë dhe sinajistikë rrugore. Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import dhe eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, hidraulike, elektrike, etj. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme. Shoqëria mund të kryejë dhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shërbim hotelier, menaxhimi i hoteleve e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktiviteti hotelier. Hapja dhe menaxhimi i bareve dhe restoranteve në funksion të aktivitetit hotelier. Kryerja e tregtimit që kanë të bëjnë me aktivitetin e hotelierisë. Ndërtime, projekte, zbatim punimesh, punime mirëmbajtjesh, import, eksport të mallrave të ndryshëm të ndërtimit, makinerive, pajisje dhe teknologjisë së ndërtimit të hoteleve.

NENI 4 **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "ZDRAVA 2025" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

- 1. Z.KRESHNIK ZDRAVA zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**
- 2. Z.GENCI ZDRAVA zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

NENI 5 **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë

- 1- Z.KRESHNIK ZDRAVA, I cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.**

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Përmet për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

"ZDRAVA 2025" SH.P.K

KRESHNIK ZDRAVA

GENCI ZDRAVA

Kreshnik Zdrava


Genci Zdrava
Genci Z
